



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 25/6 prot.

Tiranë më 17.02.2021

VENDIM

Nr. 06, datë 17.02.2021

PËR KONTROLLUESIN "COMMERCEE CORP" SHPK – BIOTE

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar (në vijim, "*Ligji*"), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*" (në vijim, "*Kodi i Procedurave Administrative*"), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Commercee Corp*" SHPK – BIOTE,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 06, datë 12.01.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "*Komisioneri*"), u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Commercee Corp*" SHPK – BIOTE, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetase në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit, konstaton se:

1. Kontrolluesi ushtron veprimtari tregtare për shitje të produkteve të ndryshme. Gjatë aktivitetit tregtar, kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë punëmarrës dhe klientë. Të dhënat e klientëve përpunohen manualisht gjatë shitjes së produkteve si dhe nëpërmjet komunikimeve elektronike për qëllim të marketingut të drejtpërdrejtë, nëpërmjet aplikacionit Vicidial.

Në këtë aplikacion, regjistrohen numra të telefonisë celulare të cilët krijohen nëpërmjet një algoritmi në një dokument në Microsoft Excel. Numrat ngarkohen në

aplikacionin Vicidial i cili më pas gjeneron telefonatën përkatëse, me qëllim kontaktim dhe informimin e qytetarëve për ofertat dhe uljet speciale të produkteve.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës nga shtetasja me iniciale B. Ll. (e cila pretendon se është kontaktuar për qëllime marketingu nga ana e kontrolluesit, pa pëlqimin e saj), në provat e e vëna në dispozicion nga kjo e fundit, u konstatua që në numrin e saj të telefonit 069..... ekziston një telefonatë hyrëse e bërë nga numri i telefonit +355682064390.

Gjatë ushtrimit të hetimit administrativ pranë kontrolluesit është administruar në cilësinë e provës *“Formulari i regjistrimit për përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme”* të shoqërisë T-Mobile (i vënë në dispozicion nga kontrolluesi).

Referuar këtij formulari konstatohet se numri i telefonit +355682064390 (objekt ankese) disponohet nga kontrolluesi dhe është përdorur në aplikacionin Vicidial për kryerjen e telefonatave dalëse, për qëllim komunikimi dhe marketingu të produkteve.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin paraprak dhe të shkruar për përpunimin e të dhënave të tyre për qëllime marketingu, pavarësisht mënyrës së gjenerimit të të dhënave (në rastin konkret gjenerimi i numrave nëpërmjet algoritmeve të përpunuara në Excel), është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë të sanksionuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 5 dhe me kriterin ligjor të përpunimit të sanksionuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 6 të Ligjit.

Ekzistenca e pëlqimit në këtë rast është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit, referuar pikës 5 të nenit 6 të Ligjit, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të Ligjit, *“duhet të jetë në formën e një deklaratë me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij”*.

3. Kontrolluesi nuk ka publikuar *“Politikën e Privatësisë”* në faqen zyrtare <https://biote-mattress.com>, në funksion të informimit të subjekteve të të dhënave sipas parashikimeve të nenit 18 të ligjit, lidhur me fushën dhe qëllimin e përpunimit, kohën e ruajtjes së të dhënave, nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare, si dhe të drejtën për të kundërshtuar përpunimin e mëtejshëm të të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë *“Politikat e Privatësisë”*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi iu mundëson atyre të njihen me të drejtat që iu janë akorduar me Ligj, si dhe iu mundëson, gjithashtu, ushtrimin e këtyre të drejtave në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi, nga ana e kontrolluesit, mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket jetës private dhe, bashkë me të, të drejtës së subjekteve të të dhënave për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale.

4. Kontrolluesi disponon kontrata shërbimi me palë të treta (të cilat në kuptim të pikës 7 të nenit 3 të ligjit kanë cilësinë e përpunuesi) të tilla si *"Kontratë Sipërmarrje"* (shërbimi dhe dhënie konsulence) me Shoqërinë HSE – Albania SHPK, me objekt: (1) Siguria në Punë, (2) Ergonomia e Punës, (3) Higjiena e Punës; (4) Mjekësia e Punës si dhe *"Marrëveshje Shërbimi"* me person fizik (p.f.) për mirëmbajtjen dhe zhvillimin dhe përmirësimin e pajisjeve kompjuterike dhe softwarët përkatës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në kontratat e lidhura me përpunuesit, nuk janë parashikuar detyrimet e palëve mbi përpunimin e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit, mbi *"Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi"* i ndryshuar.

5. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të njoftimeve, administruar nga Zyra e Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës si dhe konstatimi në vend, rezulton se kontrolluesi nuk ka njoftuar Zyren e Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 21 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim dhe për përditësimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesja e Kontrolluesit. Në datën 26.01.2021 Kontrolluesi *"Commercee Corp"* SHPK – BIOTE nëpërmjet shkresës nr. 152 Prot., paraqiti pretendimet e veta lidhur me procesverbalin e mbajtur nga grupi i kontrollit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të *Kodit të Procedurave Administrative*, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në datën 26.01.2021 u dërgua me postë zyrtare njoftimi për pjesëmarrje në seancën dëgjimore të datës 01.02.2020. Njoftimi u kthye nga posta me motivacionin “*adresë e panjohur*”, pavarësisht faktit që kjo është adresa zyrtare e publikuar në ekstraktin e regjistrit tregtar nga Kontrolluesi dhe nga grupi i hetimit është kryer hetimi administrativ në terren. Në vijim, në datën 03.02.2021, Zyra e Komisionerit ka njoftuar Kontrolluesin nëpërmjet postës elektronike, nga ku ka marrë dhe konfirmimin e tij për zhvillimin e seancës dëgjimore, e cila u zhvillua në datën 08.02.2021 me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të kontrolluesit.

Përfaqësuesi i kontrolluesit në seancë pati deklarata kontradiktore dhe të paqarta por nuk paraqiti asnjë provë të re dhe argument në lidhje me konstatimet e reflektuar në procesverbalin e mbajtur nga grupi i hetimit administrativ dhe në përfundim u qëndroi atyre pretendimeve të paraqitura me shkresën nr. 152 Prot 26.01.2021 nga Kontrolluesi.

1. Lidhur me pikën 1 dhe 2 të Procesverbalit për ushtrimin e tregtimit të drejtpërdrejtë, kontrolluesi pretendon se gjatë ushtrimit të veprimtarisë nuk përpunon të dhëna të klientëve për qëllime marketingu. Sipas kontrolluesit nga inspektimi nuk provohet ligjërisht përpunimi i të dhënave për qëllime të tregtisë të drejtpërdrejtë në kuptim të pikës 11, të nenit 3, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, kontrolluesi vendos në dispozicion të klientit politikën e shitjes, politikën për privatësinë dhe të dhënat personale dhe merr pëlqimin për përdorimin e të dhënave personale të klientëve. Kontrolluesi pretendon se nuk ruan asnjë të dhënë më shumë se 24 orë. Gjithashtu, rithekson faktin se numrat gjenerohen nga një algoritëm të përpunuar në Microsoft Excel dhe këto numra nuk bëjnë identifikimin e klientëve. Lidhur me ankesën, kontrolluesi pavarësisht se pranon ekzistencën e numrit objekt ankese në bazat e të dhënave të kontaktuar për qëllime promovionale, pretendon se nuk i është bërë i ditur identiteti i ankuesit dhe si rrjedhojë, provat e paraqitura nga grupi i kontrollit konsiderohen të paqarta dhe jo transparente, në kundërshtim me kriteret e përcaktuar në Kodin e Procedurave Administrative.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson paraprakisht se një numër telefoni, pavarësisht formës apo mënyrës së krijimit të tij ose mënyrës së sigurimit të tij nga ana e kontrolluesit, apo pavarësisht faktit nëse i asociohet apo jo identitetit të një individi të caktuar, konsiderohet, në çdo rast, si e dhënë personale në referim të përkufizimit të parashikuar në pikën 1 të nenit 3 të Ligjit.

Numri i telefonit nuk e identifikon drejtpërdrejtë një individ (subjekt i të dhënave), por një numër telefoni aktiv është i lidhur me një individ dhe e bën të identifikueshëm nëse kombinohet me të dhëna të tjera.

Në këtë rast problematika e konstatuar lidhet me dy aspekte, me atë të gjenerimit të numrave telefonik (fakt i cili theksohet edhe në pretendimet e kontrolluesit) dhe krijimi i një baze të dhënash, por nga ana tjetër me procesin e kontaktit telefonik me persona fizikë që nuk janë klientë të kontrolluesit (siç është rasti i

ankueses), për të cilët kontrolluesi nuk mund të dokumentojë pëlqimin paraprak në formë shkresore dhe të shprehur qartë siç e parashikon Ligji.

Në pikën 5 të nenit 6 të Ligjit specifikohet se mbledhja e të dhënave personale për arsye të tregtimit të drejtpërdrejtë lejohet vetëm nëse subjekti ka dhënë pëlqimin e shprehur qartë.

2. Lidhur me pikën 3 të Procesverbalit ku parashtrahet mungesa e informimit nëpërmjet politikave të privatësisë në faqen zyrtare, kontrolluesi pretendon se ato janë afishuar në faqen <https://biote-mattress.com>. Sipas kontrolluesit azhornimi i fundit i politikave të privatësisë është bërë në datën 21 maj 2020, nëpërmjet ndërfaqes backend wordpress ku regjistrohesh në mënyrë të pa alterueshme azhornimet dhe akseset në faqe.

Inspektorët e Zyrës së Komisionerit kanë kontrolluar paraprakisht faqen <https://biote-mattress.com> të Kontrolluesit ku është konstatuar se mungonte rubrika informuese e politikave të privatësisë. Një printim i faqes është administruar në provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ të kryer. Zyra e Komisionerit vlerëson se kontrolluesi duhet të marrë masa për informimin e subjekteve të të dhënave në mënyrë sa më të qartë dhe lehtësisht të aksesueshme nga përdoruesit e faqes, konform detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit.

3. Lidhur me pikën 4 të Procesverbalit ku parashtrahet se në dy prej kontratave që kontrolluesi ka lidhur me palë të treta, nuk janë parashikuar detyrime mbi përpunimin e të dhënave personale, kontrolluesi pretendon se në këto kontrata parashikohet detyrimi i palëve për përpunimin e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, kontrolluesi pretendon se palët janë në dijeni paraprakisht me dokumentin Politikat e Privatësisë dhe të Dhënave Personale të Commercee Corp, në nenin 6 të të cilit parashikohet shprehimisht përgjegjësia e palëve për konfidencialitetin dhe ruajtjen e të dhënave personale.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi, për përpunimin e të dhënave personale duhet të angazhojë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Detyrimet e palëve nuk mund të përmbliidhen në një dispozitë të vetme, por duhet të përcaktohen qartë në një kontratë të mirëfilltë të shkruar midis kontrolluesit dhe përpunuesit, në zbatim të nenit 20 të Ligjit si dhe në përputhje me Udhëzimin nr. 19 datë 03.08.2012 të Komisionerit, mbi "*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*" i ndryshuar.

4. Lidhur me pikën e fundit të Procesverbalit ku parashtrahet se kontrolluesi nuk ka informuar Zyrën e Komisionerit për përdorimin e pajisjeve video-regjistruese në ambientin ku ushtron veprimtarinë, kontrolluesi pretendon se pajisja DVR e cila bën të mundur regjistrimin e video-imazheve nuk ka të instaluar harddiskun. Në mungesë të harddiskut nuk mund të regjistrojë apo grumbullojë

informacione. Gjithsesi, Commercee Corp zotohet të marr masa për të vendosur në përdorim sa më parë pajisjen dhe të bëj njoftimin pranë Zyrës së Komisionerit me qëllim zbatimin e plotë të ligjit në fuqi.

Një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është dhe sistemi i Video Survejimit (CCTV). Zyra e Komisionerit vlerëson se pavarësisht faktit nëse sistemi i video-survejimit (CCTV) është i konfiguruar për të ruajtur apo jo imazhe-video, pritshmëria e subjekteve të të dhënave është që ata janë të survejuar, janë subjekte të dhënash dhe se gëzojnë të gjitha të drejtat që ju garanton Ligji. Një nga detyrimet kryesore të Kontrolluesit përpara fillimit të përpunimit të të dhënave, është "Njoftimi" pranë Zyrës së Komisionerit, mbi përpunimin e të dhënave për të cilat Kontrolluesi është përgjegjës (në referim të nenit 21 të ligjit) si dhe informimi i subjekteve të të dhënave sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit.

Siguria e të dhënave dhe respektimi i privatësisë mund të rrezikohen edhe në rastin kur nuk regjistrohen imazhet dhe në qoftë se ato transferohen direkt në një destinacion tjetër nëpërmjet një rrjeti të brendshëm.

Për më tepër, koncepti i përpunimit të të dhënave personale është mjaft i gjerë (referuar përkufizimit në pikën 12 të nenit 3 të ligjit), duke përfshirë në këtë rast qoftë edhe transmetimin e pamjeve nëpërmjet sistemit CCTV, përveç elementëve të tjerë teknikë.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson gjatë hetimit administrativ të ushtruar pranë kontrolluesit, në zbatim të pikës 1 të nenit 21 të Ligjit, konstatohet se njoftimi nuk është i plotë dhe i saktë dhe për pasojë është e nevojshme të plotësohet deklarimi lidhur me rubrikën 4 "Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen" dhe rubrikën 6 "Qëllimi i përpunimit" sa i takon përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV).

Zyra e Komisionerit vlerëson se pretendimet e kontrolluesit nuk e përjashtojnë atë nga përgjegjësia administrative pasi shkeljet e konstatuara, janë serioze dhe cenojnë garantimin e ligjshmërisë në procesin e përpunimit të të dhënave personale.

Gjithashtu, ndaj këtij kontrolluesi janë ushtruar dy hetime administrative të mëparshme dhe disa prej shkeljeve të konstatuara janë të përsëritura, sa i përket marrjes së pëlqimit paraprak për të gjithë subjektet e të dhënave, të dhënat e të cilëve përpunohen dhe administrohen për qëllim të marketingut, si dhe informimit të subjekteve të të dhënave mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, etj.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të nenit 39, pika 1, geramat "a", "b", "ç" dhe "d" të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, sipas përcaktimit në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

ç) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Gjithashtu, vendimi i Komisionerit bazohet në mënyrën e reagimit të kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 20, 21, 29, 30, 39 (pika 1, germat "a", "b", "ç" dhe "d"), si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 5 dhe 6 të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit;
4. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 20 000 (njëzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
5. Kontrolluesi duhet të ndalojë menjëherë formën e aplikuar për përpunimin e të dhënave personale për qëllime marketingu të drejtpërdrejtë;
6. Në vijim të detyrimit të parashikuar në pikën 5, të shkatërrojë në mënyrë të parikuperueshme të dhënat e mbledhura për subjektet e të dhënave "jo klientë" (numrat e telefonit të gjeneruara nga algoritmi), të cilat përpunohen në kundërshtim

- me dispozitat e neneve 5 dhe 6 të Ligjit. Në këtë kuadër të mbajë evidenca për shkatërrimin;
7. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, kategoritë e të dhënave të përpunuara, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë, etj;
 8. Kontrolluesi të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit përkatës, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.19 të Komisionerit;
 9. Kontrolluesi, të "Njoftojë" pranë zyrës së Komisionerit mbi përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV), si dhe të ketë në vëmendje përditësimin e njoftimit, në rast të ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale për të cilat është përgjegjëse, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit;
 10. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) menjëherë, detyrimet e parashikuara në pikat 5 dhe 6;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 7, 8 dhe 9;Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.
 11. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
 12. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit.
 13. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 17.02.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

